



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
-KOMISIONI I KONKURENCËS-**

Nr. ____ Prot.

Tirane, 14.12.2010.

V E N D I M

Nr. 165, datë 14.12 .2010

PËR

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ZBATIMIN E
PROÇEDURAVE TË PËRQENDRIMIT TË NDËRRMARRJEVE ”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Znj. Servete GRUDA Anëtar
- Z. Koço BROKA Anëtar
- Znj. Rezana KONOMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.12.2010, në mbështetje të nenit 24, të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe nenit 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

Në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërrmarrjeve”, miratuar me VKK Nr. 80 datë 05.06.2008., të bëhen disa ndryshime sipas tekstit të bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda
Anëtar

Koço Broka
Anëtar

Rezana Konomi
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R

PËR
DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN
“PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE TË PËRQENDRIMIT TË
NDËRMARRJEVE”

Neni 1

Neni 2 bëhet si më poshtë vijon:

“Kjo rregullore zbatohet për të gjitha përqendrimet në formën e bashkimeve juridike dhe faktike të dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura nga njëra tjetra, përfitim të kontrollit nga një ose më shumë persona fizik, ose juridikë mbi një ose më shumë ndërmarrje, ose pjesëve të tyre, dhe krijimit të një ndërmarrjeje të përbashkët,të përcaktuara në nenin 10 dhe që plotësojnë kushtet e nenit 12, pika 1 të Ligjit.”.

Neni 2

Në nenin 5, pika “2”,ndryshohet si më poshtë:

“2. Komisioni, në përputhje me nenin 56 të Ligjit, autorizon përqendrimin që nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg, ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese“.

Neni 3

Në nenin 8, pika “2” ndryshohet si më poshtë:

“2. Në rastin e bashkimit apo përfitim të kontrollit, njoftimi kryhet nga blerësi, përftuesi i kontrollit, në rastin e krijimit të një ndërmarrje të përbashkët ndërmarrjet që përftojnë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët dhe në rastin e publikimit të ofertës publike, nga ofertuesi”.

Neni 4

Në nenin 11, pika “6” ndryshon si më poshtë:

“6. Informacioni i pasaktë , i paplotë ose i rremë konsiderohet si informacion jo i plotë në bazë të nenit 33 i Ligjit dhe përbën shkak për vendosje gjobe sipas nenit 73 të Ligjit”.

Neni 5

Në nenin 25, pikat “2” dhe “3” të ndryshohen si më poshtë:

“ 2. Kur Komisioni konstaton se përqendrimi i njoftuar nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në

treg ose në një pjesë të tij, në veçanti si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, ai e autorizon atë në zbatim të nenit 56, pika 1 në kuptim të fjalisë së parë të Ligjit.

“ 3. Kur Komisioni konstaton se përqendrimi i njoftuar shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese e, në zbatim të nenit 56, pika 1 të Ligjit, në kuptim të fjalisë së dytë, vendos fillimin e procedurave të thelluar të kontrollit të përqendrimit ose autorizimin e përqendrimit me kushte dhe detyrime”.